



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-145

Prishtinë, më 19 shkurt 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 19 SHKURT 2014**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Petar Miletqi dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Adem Grabovci, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

**Nga OSBE-ja:** Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 shkurt 2014,
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

### **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 shkurt 2014**

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 shkurt 2014.

\* \* \*

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit lidhur me propozim-programin e punës së Kuvendit për vitin 2014. Ai tha se jemi në pritje të rekomandimeve nga Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian lidhur me këtë propozim-program dhe Planin e Veprimit për MSA.

### **2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e radhës të mbahet më 27 shkurt 2014, në orën 10:00, me këtë:

### **Rend dite**

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,*
5. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent,*
6. *Emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,*
7. *Debat parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë në shkollat e Republikës së Kosovë,*
8. *Debat parlamentar lidhur me gjendjen e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.*

Gjithashtu, u konstatua se Kryesia në mbledhjen e saj të radhës mund ta plotësojë këtë rend dite edhe me pika të tjera, që përgatiten në ndërkohë.

Për pikën e gjashtë të rendit të ditës së seancës plenare - *Emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit* diskutuan Jakup Krasniqi dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimit lidhur me pikën e gjashtë të lartpërmendur të rendit të ditës, nxori këtë:

### **P ë r f u n d i m**

Kërkohet nga Organi i Pavarur Përzgjedhës që të bëjë sqarime shtesë lidhur me veprimet e mëtejme për procedimin e propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

### **3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave**

*1. Procedimi i nismës qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit*

Kryesia, pas diskutimit lidhur me pikën e lartpërmendur, nxori këtë:

### **P ë r f u n d i m**

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit, si dhe ta përgatisë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-në të këtij projektligji në afatin prej një muaji nga dita e pranimit.

*2. Procedimi i nismës së grupit të deputetëve për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit “Hasan Prishtina”, në Prishtinë*

Për pikën e lartpërmendur të rendit të ditës diskutuan Jakup Krasniqi, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia pas diskutimit lidhur me pikën e lartpërmendur, nxori këtë:

### **P ë r f u n d i m**

1. Propozimi i grupit të deputetëve për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë t’u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media që, në konsultim me Senatin e Universitetit “Hasan Prishtina”, ta shqyrtojë propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

*3. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së për debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të IGK “Ballkan”, në Suharekë*

Për pikën e lartpërmendur të rendit të ditës diskutuan Jakup Krasniqi, Sabri Hamiti, Adem Grabovci dhe Visar Ymeri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimit, kërkesën e lartpërmendur të Grupit Parlamentar të LDK-së për debat parlamentar e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës.

*4. Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarit në komisionin parlamentar*

Kryesia pas diskutimit, propozimin e lartpërmendur e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës.

*5. Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

**V e n d i m**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit, në këtë përbërje: Suzan Novobërdaliu, Kymete Bajraktari, Arsim Bajrami dhe Armend Zemaj, si dhe nga stafi mbështetës i Administratës, Visar Krasniqi, Merita Drenori dhe një zyrtar i Transportit të Kuvendit, për të marrë pjesë në konferencën me temë “Të drejtat themelore, orientimi seksual dhe identiteti gjinor”, që do të mbahet në Kuvendin Kombëtar të Shqipërisë, prej 3-5 mars 2014.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për një natë për deputetët dhe një zyrtar të Administratës mbulohen nga Kuvendi i Kosovës me mundësi rimbursimi nga Parlamenti Evropian, ndërsa shpenzimet e akomodimit për natën tjetër për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi, si dhe të gjitha shpenzimet e akomodimit për dy zyrtarët tjerë të Administratës, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

**Pika shtesë:**

*1. Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

**V e n d i m**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Xhafer Tahiri, Adem Grabovci, Afrim Hoti, Bali Muharremaj, Albert Kinolli, si dhe nga stafi mbështetës i Administratës, Fatime Qorri, Mehmet Simnica, një zyrtar i përkthimit shqip-serbisht dhe një zyrtar i Transportit të Kuvendit në Republikën e Shqipërisë prej 23-25 shkurt 2014.

2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*